

Lasgush Poradeci
Zemra e liqerit

Dirgjet shpesh liqeri-i kaltër
e pushon në mes të ditës,
sipër tij buçet prej fundesh
pasqyrim' i ti shëndritës.

Val' e urtë i shtrohet anës
dal-nga-dal e fashe-fashe,
që prej zallit të përbujshëm
nisen lundrat levorashe.

Po atje ku nisen lundrat,
sipër valëve paqtore,
me rrëmbim të zemëruar
uji hap një gjeratore.

Hap me gjëmë llahtarie
plagë-e hon në kraharuar
ndaj largohen sërë-sërë
që prej zallit të shkretuar.

Fjalor:

dirgjet – rri pa lëvizur

fashe-fashe - qetë-qetë

levorashe - e shpejtë

paqtore - paqësore

gjeratore - vorbull uji, shtjellë uji

sërë-sërë - radhë-radhë